

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E ENJTE 12 MAJ 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuara karrige bosh,

Disa herë jam ngjitur në këtë foltore për t'u marrë me mënyrën se si qeveria e menaxhon jetën publike, me një shans kritik, si logjikë opozitare. Sot jam këtu për një gjë më ndryshe. Unë besoj se krizat që kalojnë partitë e mëdha, të cilat udhëheqin pushtetin apo opozitën në vend, i përkasin të gjithë shoqërisë. Duket sikur një palë digjet dhe tjetra ngrohet, por ato, në fakt, krijojnë efektet e rrezatimit atomik, duke prodhuar deformime afatgjata. Zakonisht krizat mbyllin ose përkufizojnë një epokë. Ato bëhen lajmëtares e një tjetre, e cila mund të bëhet më e mire ose shumë më e keqe.

Dua t'ju kujtoj në histori të shkurtër. Në vitin 390 para Krishtit, Athina, e mundur së fundi nga Sparta në Luftën 30-vjeçare të Peloponezit, ishte një qytet në krizë. Humbja në konfliktin më të rëndësishëm në historinë greke vuri në pikëpyetje vetë sistemin demokratik të Polisit, të përsosur nga burrshtetasi Perikliu. Në fakt, në vitin 404 Sparta favorizoi një pikë kthese në sistemin kushtetues të Athinës me lindjen e qeverisë së Tridhjetë Tiranëve, të kryesuar nga Kritias. Përvoja oligarkike e Athinës zgjati vetëm tetë muaj, derisa Trasibulo udhëhoqi fraksionin prodemokratik në rivendosjen e formës tradicionale të qeverisjes së qytetit. Megjithatë, një nga aktet e para të demokracisë së rivendosur është dënimi me vdekje i Sokratit në vitin 399, i konsideruar si armiqësor ndaj vlerave të Athinës.

Më ka intriguar gjithmonë vdekja e Sokratit si çmim që paguhet në emër të se vërtetës, po kaq, psikologjia e turmës, pasi e kanë hequr qafe, vuajtja dhe mundimet e saj për t'u rikthyer nga turmë në shoqëri, e cila kërkon përsëri Sokratin. Vdekja e tij, e cila përsëritet si metaforë, si dialektikë e përpjekjes, i ka ndihmuar njerëzit gjithmonë të reflektojnë mbi qeverisjen vertikale, mbi cezarizmin në politike, mbi dekadencën, tribalizmin, banalitetin, violencën dhe luftën, të cilat lindin në një mendje për të pushtuar ato të një grupi, organizate apo të krejt një populli. Përkatesinë time në Partinë Demokratike e kam përjetuar gjithmonë në mënyra të ndryshme, qëkur jam anëtarësuar në të, në kodrat plot iluzione të Qytetit Studenti pas referendumit të vitit 1994.

Dikur me militantizëm, i cili ka shumë pasion e më pak arsye, i kam lexuar sjelljet e saj. Militanti ndizet kur i thuhet se po bashkëpunon me armikun dhe, kur atë ia thotë lideri, edhe më shumë ndizet ai. E kam provuar së brendshmi këtë ndezulli e furi për “armiqtë e shumtë” që partia jonë mbajti në gji. Urrejtja paguan më shpejt, edhe më shumë se dashuria. Më vonë jam rigjendur në të me modesti, kritikizëm e dëshirë për të kontribuar, për të vënë ndonjë ide në murin e madh, ku prej 32 vjetësh mijëra demokratë e bëjnë, herë me qetësi e herë me pezëm, duke ikur e duke u rikthyer. Por ajo që po ndodh brenda partisë kryesore të opozitës gjatë këtyre muajve, nuk është thjesht një krizë politike, por një tregues i fortë antropologjik i kulturës politike në vend. Kjo krizë nuk mund t’i ikë kësaj salle.

PD-ja ka lindur si parti që ju kundërvu absolutizmit dhe, teksa bënte këtë betejë, shpesh binte vetë në pozita absolutizmi. Gjithaq ka lindur si parti që lufton komunizmin, forma të të cilit zhvilloheshin edhe brenda saj. Por të zgjon krenari fakti që s’kanë munguar kurrë gjatë këtyre viteve individët dhe grupet që janë përballur me këtë mendësi. Disa kanë humbur karrierat dhe të mirat që ajo sjell, duke pësuar simbolikisht fatin e Sokratit. Kur ka pasur reflektim për kushtimin e lëshuar, ajo është bërë më demokratike dhe Shqipëria po aq; kur ajo është bërë fituese, edhe Shqipëria po kaq ka fituar. Sot, pas 32 vjetësh, ajo është në një kapërcyell ekzistencial mes ideve të reja dhe tabuve të vjetra, individit dhe kohës, gjykatës dhe ndjesisë popullore. Por në konfliktin disamujor sot nuk jemi në këtë pikë, për fat të keq, se përplasen dy mentalitete, një i ri e një tjetër i vjetër, një më demokratik e një tjetër më autokratik, jo, e përsëris, në këtë pikë na ka çuar “lufta civile” brenda të njëjtit mentalitet e mendësi.

E reja, e ndryshmja, demokracia universale nuk zë në truallin e unit, në tokën që ujitet vetëm me interesa personale, të cilat ambalazhohen si kauza të përbashkëta. Kriza tejkalohet kur shfaqet një mendësi e re, qoftë edhe minoritare në fillim. Në PD sot gjithkush flet për gjithçka. Në PD sot s’ka tabu, nuk ka as mite, thjesht një muze i përkohshëm për to. Zërat e shumtë i japin fytyrë krizës, por edhe mund ta zgjidhin atë. Il potere logora a chi non ce la, - thoshte Andreoti, dhe vërtet në të PD-së na ka lodhur e na ka konsumuar pushteti i munguar, me shpresën se e gjithë kjo shërben për të ndryshuar kulturën politike në vend. Kjo ndodh nëse turma nuk kërkon gjithmonë kokën e Sokratit, në emër të tiranit. Çfarë kemi në si opozitë përballë?

Një absolutizëm interesash! Hermetizëm, heshtje, individin dhe masën, pushtetin dhe nënshkrimin ndaj tij, pushtetin që nuk lodh bartësin e tij, por të gjithë Shqipërinë. Janë dy anë të një mentaliteti: njëra në krizë, se nuk ka pushtetin, tjetra ka vënë në krizë vendin me pushtetin pa kufi; njëra tenton të dalë prej unit, sepse nuk ndan pushtet, tjetra pranon unin nga pesha e pushtetit, duke pritur krizën si çështje kohe. Njëra është ana ime, tjetra ana juaj. E para jep më shumë shpresë, e dyta e vë në diskutim atë. Kudo

kriza e demokracisë dhe e partive ka rrjedhur nga prishja morale. Politikani që gënjen, që betohet rrejshëm, që jep shembuj të jetës abuzive, që sulmon rendin kushtetues jo vetëm duhej akuzuar dhe duhet përjashtuar nga loja e pushtetit, por duhej goditur menjëherë nga verdikti i padiskutueshëm i opinionit publik. Opinioni ynë publik është nën diktat, nuk është shndërruar ende në diktat për individët.

Të dashur kolegë deputetë,

Kriza të tilla parandalohen me refuzim estetik, etik dhe politik. Ato i bënë shoqëria, sa herë ta gjykojë si krim vrasjen e Sokratit. Faleminderit!